

Ahmet Prençi

*Udhë
në pasqyrë*

Poezi

BOTIMET M&B

Ahmet Prençi

UDHË NË PASQYRË

Poezi

BOTIMET M&B

Autori:
Ahmet Prençi

Titulli i librit:
UDHË NË PASQYRË
Poezi

Redaktor: Besnik Mustafaj

Recensent: Islam Çenga

Kopertina: Zaim Elezi (Zaya)

ISBN: 978-9928-172-85-3

© *Autori*

BOTIMET M&B

Rr. "Isa Boletini", Pall. "Planet X", Nr.12, Tiranë
Tel. +355 4 2233283 Cel: 0692068603 / 0686508441
E-mail: mbbotime@gmail.com www.mbbotime.com.



M&B - Botime dhe Studio Grafike

**Nënë Lushe
dhe vajzë, Eriona**

1

Varg lidhur malet

ATDHEU

Atdheu u ngjitet shkallëve gjer në qiell
E poshtë zbret deri në zemrën e tokës;
Atdheu është pranverë që fryn si fyell
Dhe një kokërr mollë në prehrin e Lokes.

Atdheu ngjitet kapilarëve, aortës sime
E zbret poshtë si drithërimë e zemrës;
Atdheu është bekimi i çdo fryme,
Vështrimi im, ëndrra jonë e shpresës.

Atdheu ngjitet në mal, zbret në fushë, lahet në det
Dhe flokët i kreh në zjarr si Prometeu;
Atdheu s'ka mort, s'ka parajsë e ferr,
Te të gjallët e të vdekurit, është ATDHEU!

NË VEND TË BALADËS

Lart në mal ku syri tretet
Krejt i largët, krejt i turbullt,
Cjap i egër turfullon
Dhi e egër seç ka humbur.

Se janë dashur në çdo stinë
Puthur, ndukur, përçafuar;
Sa herë cjapi dredh mustakun,
Dhia pranë e përmalluar!

E janë puthur, trashëguar
Nëpër shkrepë, në çdo stinë;
Cjap i egër thyen shkrepë
Se ka humbur grua-dhinë.

E lëshon piskamë e lot
Sa orteqet shkundin malet;
Cjapi egër përpjek brirët
E me thundra po çjerr faqet.

Se ka humbur grua-dhinë
E kërkon, rrëmon ngado;
Ka humb shtëpinë, katandinë
Perëndeshën, si ajo!

E TREGUAR PËR KALIN

Zbret një kalë poshtë zallit
I ngarkuar mbi kurriz,
Pas thërret, godet kafshari
I kërrusur si murriz.

Mënjanohet kalë i plakur
Punëhumbur, kockadalë;
Një dorë jonxhë, një grusht tërshërë
E një vdekje pak e mbarë...

Mbyll qerpikët e mbyll sytë
Me përtesë mizat përzë,
Por në krifat si degë shtogu
Krenarinë aspak s'e lë.

E kjo botë kështu është ndarë,
Dikush mban, dikush godet,
S'ka dyshim që është i marrë,
Kush e quan veten mbret.

GJIROKASTËR, PRILL, 2003

Ja, në majë del hëna
Si një kllonjë me yje,
Po zbret Argjiroja
Gjithë nur, gjithë hije.

Me shaminë lidhur
Si bora mbi ballë,
Nëpër shpate derdhur
Fustanellë e bardhë.

Poshtë nga Ur'e Lumit
I shkëlqen fitira
Krihet në Këcull
Në dhjetëra pasqira.

Xhevahir nga brenda
Në rrugë e sokaqe,
Në shtëpitë e gurit
Si me feste rrase.

Palorto, Varosh
Ngjitet gjithandej,
Sa në Manalat
Në Kala, përtej.

E krejt e mahnitur
Me hijeshinë brenda,
Humbur kuturu
Me mendje, pa mendje!

Frihet në damarë
Drino - Virua,
N'Zagori, Çajupi
Po harbon ndër gra!

Ziejnë brenda teje
Fjalët, thashethemet
Dalin nga ballkonet,
Ngjiten nga bedenat.

Për një vajzë “përdalë”
Për një plak të pirë,
Rrush janë thashethemet
Me ngjirë e pa ngjirë.

Në tigan një vé
Për një a di vetë,
Por këpucët hahen
Në kalldrëm, medet!

Hahet, mpihet era
Dhe shiu ndër strehë,
Tinëz Kadareja
Argjironë e sheh.

I ka rënë në krye
Argjironë për grua,
Varg janë thashethemet
Nga pragu në krua!

* * *

Sa paqësorë, të dashur
Janë gjirokastritët
Si me jabanxhiun,
Ashtu me të tijët.

Eh, moj Gjirokastër,
Ç'më bëre, medet!
Krejt i dashuruar,
Krejt, me ti, jam mbret.

REKUIEM

-Sokol Olldashit-

Vrapove shpejt në jetë
Nata nuk ishte për gjumë,
Kohë e marrë, e trazuar,
Miku im, dyfish i jetuar!

Orët-sekonda,
E muajt-ditë,
E vitet-muaj
Kaluar!

Ndaj ike papritur,
Në ecje, në furtunë
Me gishtat e hënës të thyer,
Me fatin e natës në grackë
Në pusi, të gjitha bashkë!

Ece në jetë
Me gotën që të kishte hije,
Me këngën në shpirt,
Me fjalën batutë
Të hollë,
Të çlirtë;

Me mendimet,
E shikimin e thellë plot dritë,
Me cigaren ndezur gjithherët në buzë,
Me fobinë e qiellit në udhëtime
Ku fluturove krejt i vetëm;
Me poezinë si burim me muzë;
Me buzëqeshje si valë,
Oh, sa e bukur,
Oh, sa miqësore,
Oh, sa e rrallë!
Janë “tungjatjeta”, miku im,
Për ne,
Për mua,
Për të gjithë në udhë
Të vdekur e të gjallë...!

Ike.
Dyfish jetove,
Dhjetëfish dhurove,
Njëqindfish krijove,
Pafundësisht dashurove!

Ende nuk dua ta besoj
Se jam
Përballë trupit tënd të mermertë,
Me shpirtin tënd të lirë në parajsë,
Me sytë plot shpresë e shkëlqim
Me cigarishten ende në buzë, ka gjasë...!

E tillë qenka kjo jetë e mbrapshtë
Mall, miku im, shumë mall...!

C.V. NË KOHËN E DIKTATURËS

Unë, Filan Fisteku, i datëlindjes gjashtëdhjetetë
I biri i Diellit dhe i Hënës,
Me origjinë homosapiens
E tani kooperativist,
I rrudhur nga hallet si sfurku i thanës,
I pastër politikisht,
Si të gjithë,
Alla komunist...

Ju përgjerohem për të drejtë studimi për shkollën e lartë;
Si kokrrat e misrit në kalli kam dhjeta;
Sjellje shembullore
Flakë në punë,
Si bleta.

Si sorrat
Që ulen vonë mbi man e mbi lis
Shkruaj fjalët:
Zemërgjerësia juaj.
Drejtësia e Partisë.
Zhgarravis: Drejtësia e Partisë.
Shkruaj thjeshtë: Dora e Partisë.

Pastaj:
Lavdia.
Urtësia.
Besnikëria.
Pavdekësia.
Madhështia...

Pastaj:
Siç mbyll babai kuletën bosh
Pa një grosh,
Si kërcitje gishtash nga merak;
E mbyll tekstualisht:
Përshëndetje nga Reçi.
Nga unë, Ahmet Prençi!
Pikë!

“SHKENCË”

Ne bëjmë shkencë në parcelën eksperimentale të shkollës
Hibride, kryqëzime, shartime e ku di unë se çfarë,
Si bukënore e mykur dielli në qiell
E hëna, pagure me dhallë.

Ne bëjmë shkencë. Endërrojmë për nesër.
Për hibridin e lindjes, aliazhin e vdekjes.
Të rilindjes. Të rivdekjes.
Nëna lan rrobat poshtë në përrua,
Babai dredh cigare me fletën e gazetës.

Ne bëjmë “shkencë” në parcelën eksperimentale!...

SEKRETARI I PARTISË

Serioz,
Si një qiell me re.
Veshur me xhupin ushtarak me jakë dhelpre
Ngjeshur në trupin e zverdhur të vjeshtës.
Ky është magjistari, them unë i magjepsur;
Për jetën e babait e mbarë ne të tjerëve...

I mençur, i aftë, pjellor
Si pëllëmba e tokës buzë lumit;
Me shall e këmishë të kuqe në all
Si myshku i lisit mbështjellë rreth kurmit.

Filozof, dijetar, mendoja për të dikur,
Në oborret tona si trungje të prera,
Me tëmthe e vetulla të ngrira e gjithë ferra;
Ky është Zeusi, mendoja unë,
Pastaj perënditë e tjera.

Pastaj më tremb si një lugat sekretari
E xhindet mblidhen kokë më kokë si të mpirë;
Bie shiu i ftohtë mbi supet e natës
Dhe borë e stuhi presim në të gdhirë.

LLAMBA E VAJGURIT

Në polisën e oxhakut llamba e vajgurit
Me shkrepësen ngjitur, tymi e flaka,
Sa herë suferina fryn e fik dritat
Si magjistare ndez llambën, më plaka.

Aladini ndrit në heshtje natën e errët
Të fryjë suferina, bora të ngrijë pragun,
Ajo llambë magjike që nëna fshin ngahera
Yll i rënë nga qielli në qoshen e oxhakut.

Ne ikëm në qytet. Mbyllëm shpi e katandi
Llambat e vajgurit s'janë për qytetet!
Por nëna e mori, e ruajti të shtrenjtë
Aty pranë dritares, aq pranë me shkrepësen.

E lan e pastron me shumë dashuri
Për të mbajtur ndezur mallin në gji...

PËRJETIM

E varrosëm të vdekurin e radhës
Megjithëse ishte dimër me borë e me ngricë;

Të vdekurit varrosen në të gjitha stinët,
Në të gjitha stinët kanë lindur një ditë;

Në lindje e në vdekje jemi kaq njerëzorë,
Në vdekje e në lindje s'jemi hipokritë...

PYLLI ME PISHA

- Në kujtim të babait -

Pylli me pisha të moçme
Si xhaketa e babait varur në gozhdën e kreshtës,
Nëna ia ka kthyer dikur jakën,
Jakën e rrjepur nga kripa e djersës.

Pishat e moçme me jakën e kthyer
Nga e gjelbërta në jeshile,
Aty xhaketa e babait
Ka mote që bën hije!

Pylli me pisha të moçme
Anuar nga era e luginës si kërrabë,
Rrudhosur si xhaketa e babait
Në acar dhe në vapë.

Rralluar pylli me pishat e moçme;
Rrudhur e rrjepur si xhaketa e babait
Pa portofol, pa xhepa e pa kopsa...

KULLA

Po shembet kulla në fshat
I ka rënë suvaja, hatullat, parvazet;
Muret mezi mbahen në erën e thatë
Siç mbahen me paterica sakatët...

E anuar kulla.
I dhëmbin ijet.
Kurri i dalë.
Reumatizma ia ka mpirë këmbët;
Me syze miopi anuar në një anë,
Si nallane i kërcasin dhëmbët.

Qindra vjet do të rronte kulla
Ndërtuar me gurë e gëlqere safi;
E shkretë vatra e udha pa njerëz
Vdes dhe Planeti po s'pati njeri!

QASJE

- I admiron -
të tallin;
- I përkrah -
të përdorin;
- I ndjek -
të gënjejnë;
- I harron -
të urrejnë;
- I përçmon -
të vrasin.

EPITAF NË AKULL

Mbi akullin e pellgut
Epitafin shkrova!
Ditëlindje të saktë,
Ditëvdekjen e sajova.

Të nesërmen epitafi
U shkri nga rrëkeza;
E si mund të vishej
Nëna me të zeza?

NË SHARR

Malet e Sharrit
Si lëkurë ariu nderur nëpër re;
Është dimër...

Malet e Sharrit
Si krismë pushke mbi valët e Lumbardhit,
Digjen si shami e beqarit.
Është verë...

Malet e Sharrit në të gjitha stinët
Me sharki në duar
Zbukurojnë shpirtin.

SHTATOR, 1986

Ika.

Nuk mora asgjë me vete;
Veç mallit
E xhaketën e kadift' ngjyrë toke,
Kutinë e duhanit me serm të gjyshit,
Pantallona xhins me ngjyrën e Drinit,
Atlete të reja me bojë tërfili...

Ika.

Nuk mora asgjë me vete
Veç ca lekë që m'i dha babai
Nga kursimet e fundit;
Kursime si gjethet e blirit në prag dimri
Mbi valët e lumit.

Ika.

Me një valixhe druri me vete,
Lyer me bojë zmalte,
E mbushur me ëndrra...

“RRËNJË KATRORE”

-Mësuesit tim të matematikës-

Mësues Isai i matematikës
Është “shkencëtari” në këtë hapësirë shkolle
E deri tutje pas maleve.
Ndoshta dhe më tutje ku mbaron bota.
Në rrënjë katrore është qielli,
Livadhet, tërfili, trungu i thanës,
Ku pret udhët drapri i hënës...

Në emërues të përbashkët
Unë me shpirtin,
Me udhën për në shkollë,
Me bukën e misrit futur në çantë,
Me pak gjalpë lyer hollë;
Me ca libra e fletore të kapura në grackë,
Me ngutjen për kopjim detyrash
Në qoshen e shkollës sa një mackë.

Ne jemi sinuset.
Kosinuset, thonë xhindet,
Dhe thirrin në apel emrin tim,
Emrin në kujtim të gjyshit,
Të gjyshit me mustaqe sa misri,
Që nuk dinte shkrim e këndim.

Thonë se jeta ime është e gjatë,
E gjatë dhe e rrëmujshme
Si mëllenja që s'ka ç'të veshë në dimër.

FARAONË E SKLLEVËR

Varret e faraonëve ndërtuar,
Nga sklevërit
Me mijëra, miliona, si milingonat.
Adhuruar po nga sklevërit,
Me mijëra, miliona,
Nga lindja në vdekje
Me mijëra, miliona...

Në sarkofagë skeletet vazhdojnë jetën
Janë shpirtra perëndish
Aspak të prekshëm,
Asnjëherë të rrejshëm,
E kurrë të vdekshëm...

Numërohen me gishta faraonët
1, 2, 3...20
Sklevërit me mijëra, miliona
E janë të vdekshëm
Por nuk kanë varre,
As sarkofagë,
As epitafe,
Tamam si milingonat,
Me mijëra,
Miliona,
Miliona...

RIMA PREJ BORE

E paqtë, e butë, e lehtë, e pafajshme
Mbuloi mëkatet në mal e në fushë,
Në borë s'ka frikë, mbi borë s'ka pritje,
Siç presin të dashuruarit puthjen në buzë.

E kam pritur borën si një ëndërr të mbrame
Me gushkuqët strukur nën hatulla e çati,
Nesër nëna ime s'do të veshë nallane
Por triko të leshtë, çizme e sargi.

E kam pritur borën si mikun te dera,
Që mollëzat e tokës enkas t'i zbardhë.
E çiltër kjo bora, si vajza ime Era
Eriona e mirë - e urta, borëbardhë.

E paqtë, e butë, e lehtë, e pafajshme
Shkrin në gjurmët e mia pastaj...

NGRICË

Pellgje të acarta këto ditë janari,
Kanali pranë shtëpisë kallkan gjithsesi,
Kënga e bretkosave ka rënë në të shurdhët,
Kam frikë se kanë ngrirë nën akullin e zi.

Pellgjet si pellgjet, janë për bretkosat
E unë ashik i djegur për ty...

PO VJEN DIMRI

Vizatime fëmijësh fshin goma vjeshtë,
Avuj në kaltërsi
E yje pafund.
Pastaj
Një Diell dhe një Hënë,
Një shtëllungë me re,
Përgjysmë një rrufe,
Një tufë me dallëndyshe,
Një urë ylberi,
Një valë lumi,
Sandale plastike,
Një shtërg me lejlekë,
Një letër e zverdhur
Mbetur në kuletë...

Gozhdët e fundit po m'i shkul si eshtrat
Kjo vjeshta e tretë...

LULE LISNE

Lule lisne mbledhim në verë
Për groshët në dimër t'i thajë nëna,
Odat të mbushen me aromë,
Me erën dehëse jashtë edhe brenda.

Për rrënojat nuk jam arkeolog
As në livadhe një bujk për plisa,
Unë thjesht po mbledh nektarin
Me nektarë në mollëzat me lisna.

Pas meje le të vijë si të dojë dimri
Me erë, me borë, lloh e furtunë,
Lisnën e mbledh që në ditë-verë,
Ditë-verën çoj në shtëpi për gunë.

E nëna ime e urtë dhe e mirë
Me lisnën bën edhe ndere,
Për xhajen e hallat në qytet
Pak lisna mbështjellë si ditë vere.

PËRSËRI PËR VETE

Zotat e mi nuk janë oqeaneve,
Honeve të thepisura të maleve.
Zoti im në shpirtin tim,
Të katragjyshit, stërgjyshit, gjyshit e babait.

Zotat do të përlesheshin në qiell
Po të ishin me dhjetëra,
Do të ishin vrarë si njerëzit me heshta,
Nga frëngjitë e kullës me snajpera.

Zoti është Një në shpirtin tim
Të katragjyshit, stërgjyshit, gjyshit e babait.

KU BASHKOHET DRINI ME BUNËN

Stinët në degët e bredhit janë të gjelbërta
Në sytë e tu, blu të katër stinët,
Aty ku bashkohet Drini me Bunën
Aty sytë e tu me sytë e mi shkrihen.

Drini buron e rrjedh nga malet e mia,
Nga sytë e mi tharë si thëngjilli;
Derdhet nëpër Bunë si hamshor i egër,
Tretet si dëbora në fillim prilli.

Stinët janë blu si sytë e tu, e dashur
Si zogjtë në pranverë cicërinin,
Në sytë e mi nata fik thëngjijtë
Aty ku bashkohet Buna me Drinin...

Përtej nesh fshihet dashuria
Nga sytë e botës përpjekur!
Por dashuria mbeti dashuri
Në katër stinë, në katër shekuj.

MBRËMJA NË FSHAT

Para se të perëndojë dielli
Njerëzia shpejton të sosë punët e ditës:
Zogjtë për gjumë shtrojnë dyshekët me pupla;
Kujt shkundin pluhurin çokollatë të udhës;
Lopët mbushin grushtet me qumësht;
Nëna për vaktin e darkës kripos groshët;
Motra fsheh nën qepallë të parën puthje;
Shelgjet në buzë lumi varen si gërsheta;
Bleta në koshere me lloz mbyll deriçka;
Pulat flenë si pulat;
Merimangat, si merimanga struken në skuta,
Mushkat flenë në këmbë si mushkat;
Derën e avllisë së fundmi e mbyll babai...

Kur hëna-kloçkë të mbledhë zogjtë-yje
Niset për në qiell ëndrra ime...

PËR VETE

Ne mblidhnim xixëllonja në grushtat e dritës
I fusnim në magje që të shtohet mielli,
Në mbrëmje kur Drini puthej me brigjet
E në buzë laureshe këndonte fyelli.

Harroheshim në udhë, harbonim në brinja
Me djersë të pathara, me këmishën jashtë,
Hakërrehej nëna me gratë e mëhallës:
Ky Meti i vogël, s'i la dy gurë bashkë!

ERA ËSHTË ZËRI IM

Era është zëri im,
Mbaj vesh
Se si suferina thyhet nëpër lisa
E dega e manit bëhet violinë;

Burimi është vështrimi im,
Vështro
Se si djerra bëhet kopshti i Edenit
E zalli tel për violinë;

Guri është qëndresa ime,
Beso
Se heronjtë, të rënë e të gjallë
Po këndojnë mbi violinë;

Udha është eshtra ime,
Udhëto
E në më shkele në gjurmë
Do ta kemi shpirtin njësh në violinë;

E nesërmja është stacioni im,
Jeto
Se ëndërrat nuk vdesin kurrë
Janë zogj që nusërojnë në violinë...

RROKJET...

Me kurrizin e pëllëmbës nën mjekër
Ndaj rrokjet e fjalës
Në valë lumi,
Në pika shiu,
Në gaca prushi,
Në gjethe vjeshte,
Në guacka deti,
Siç na thotë mësuesi.

Pastaj,
Ndaj gjurmët e rrugës
Në gjurmë bagëtish,
Zogjsh,
Kuajsh,
Mushkash,
Zanash,
Në gjurmë njerëzish,
Bisedash,
Ndarjesh;
Thashetheme pa fund
Për të djeshmen,
Për të sotmen,
Për të nesërmen.

Pastaj më merret mendja,
Me pëllëmbën e yjeve nën mjekër,
Mbështes kokën në “Majën e Madhe”
Dhe pres absurdin si i verbër.

GJURMË

Gjurmë opingash, lopësh, gomerësh e gjithfarë,
Pastaj përshëndetjet njomur si cigaret në buzë,
Pastaj një hall a një puthje në kryqëzim të erës
Dhe një lindje e një perëndim lidhur tërkuzë.

Në udhë pëshpërima, thashetheme grash
Shtyhen me brryla, me llërë anash, në skaj;
Nuk dalloj gjurmët e fisnikut nga i ligu,
I harruar si i marrë pas teje jam pastaj.

Pa lamtumirë pas dashurisë
Si gjurmë mbi gjurmë mbetur fakir,
I ligu mbeti pas në udhë
E unë pas teje si mars i ngrirë.

GALAKTIKË

Ranë yjet nga qielli në ograde, mbi oxhaqe
Në gardhe, në valët e Drinit e lule shtogu,
Renda si i marrë t'i mbledh ende të pafikur
Në pëllëmbë fëmije mbledhur si fole zogu.

Me sytë katër, me krah shqiponje. Zgjuar!
Në udhë, sokaqe, pllaja, gjer poshtë në zall. Harruar!
Si kalë i hazdisur me patkua djegur. Harbuar!
Në ballë, në gushë, në shpirt. Ndriçuar!

Bien yjet nga qielli,
Të tjerë yje ngjiten
Në brigjet e mia.

KORABI

Jam zgjuar që në lindje me Korabin në sy,
Me Udhën e Diellit - që pa gdhirë jam zgjuar,
Lind dita me Korabin e diellin përkarshi
Ngryset nata mbi Kurorë - përmalluar.

E njoh më së miri me gjysh e katragjysh,
Sy më sy i hapim kanatat,
Me nurin e ditës i ndrisin siluetat,
Në muzg të perëndimit me të kuq përflaket.

Korab! Përtej reve, përtej qiellit,
Përtej ëndrrës, përtej zhgjëndrrës,
Lahet me sirenat e Egjeut
Krihet nëpër erërat e mëllenjës.

Perënditë në Olimp i kanë shtëpitë
Në Korab bëmat, intrigat, dashuritë...

HARKU I YLBERIT

Vargjet e mia nuk kanë tumor
As lebrozën e tmerrshme në fytyrë
E shumta një pleurit të lehtë në rima
Nga era e vjeshtës në brinjë.

Thonë që jam naiv në dashuri
Se dua me shpirt, dua pa cak
Thonë se në urrejtje jam prap naiv
Se s'di të urrej, ose urrej shumë pak...

Thonë që jeta e njeriut varet në fije të perit
Në fije të perit ndoshta jam unë,
S'kam kohë për urrejtje, të dashur miq
Për dashurinë jam qiell pafund...

Në harkun e ylberit
Një ngjyrë më shumë...

NËNA

S'ka më të bukur se ti,
Me sy të mëdhenj - një pash qiell
E prehrin me nektar perëndish;

S'ka më fisnike se ti,
Me zemrën e dhembshur për një zog të trembur
E me kurmin - Zanë bjeshke.

S'ka më të shtrenjtë se ti,
Që mbushe fletën time të bardhë
Me dashurinë e sakrificën bashkë;

S'ka më punëtore se nëna ime,
Qelibare, e urtë, ëmbëlsi në ëndërr
Që më bekoi ende pa u ngjizur;

Nëna ime, Hirushja në zhgjëndërr!

ERA

Erë ftua
Erë molle
Erë jete
Je për mua.

Erë shtogu
Erë udhe
Erë lumi
Je për mua.

Erë bliri
Erë mimoze
Erë deti
Je për mua.

Erë mali
Erë bore
Erë lëndine
Je për mua.

Erë lisash
Erë ahesh
Erë tërfili
Je për mua.

Erë vjollce
Erë buke
Erë mjalti
Je për mua.

Era e shpirtit
Era e qënies
Era e gjakut
Je për mua.

Mbi të gjitha ëndrrat
E mira, e shtrenjta,
Bija ime, Eriona...

PRUSH LISI

- Në kujtim të gjyshit -

Treten drutë e prera në zjarr,
E mbetet thëngjilli, shtrohet hiri;
Një jetë të tërë toka rriti lisin
E vjen një çast e tretet si qiriri.

E ngrohet gjyshi im i urtë, e thith cigarin
I kthen shpinën flakës se kockat i dhëmbin,
Pastaj me një mashë fort trazon zjarrin,
Siç shkund e nduk rrufeja shkëmbin.

Gjyshi im i mirë në një fund vjeshte vdiq,
Për të ngrohur tokën në dimër, si lis.

SHKODËR, TETOR, 2006

Kaloj në Urën e Bahçallëkut
Dhe lë veten në Shkodër,
Ku motra Tone fshihet nga syri i keq
E në një sy dielli, struket Luli i Vocërr.

Përulet Taraboshi si fëmijë motak
Pi sisë në gjirin lënë jashtë të Rozafës,
Në Zdrale, në Rus, në Serreq e Parrucë
Hëna ujdís vathët e rruazat e qafës.

Nadja e mirë Shkodër! Zbardhin udhët, avllitë,
Çelen dritaret, dyert aromë nga karafilat,
Fluturojnë në ajri e puthen mijëra zogj
Zymbylat, pëllumbat, kanarinat e bilbilat.

Dal tek Ura e Bunës,
Veten e ankoroj si sule në liqen
Dhe marr me vete si ëndërr Shkodrën...

BASHKIMI

I pakët Bashkimi,
Dhe duhanin imtë e grinte
Në oborrin mbuluar me lule molle,
Ulur mbi trungun e manit si stoli sajuar.

I imtë Bashkimi,
Fjalët grinte imtë
Siç grinte dhe hallet,
Ku mbështillej jeta
Me letrën e cigares...

Dhe dielli në udhë
Përflakej shpuzë
Nën hardhitë si vetulla të rëna
Të ndera si një bluzë.

MAHMUT DAC' KALISI

Mahmut Dac' Kalisi
Shtatë pash sa lisi,
Kullën sa gjith' fisi.

Ka lëshu piskamë,
Për të mbrojt' vatanë,
Nga turqit nizamë.

Kulla istikam;
Mahmut Dac' me nam
Për liri, vatan.

Për vatan ti bie,
Si fishek alltie
Vdekja ç'të ka hije!

Shtatin Veleshicë,
Kryet në Gjallicë,
Mahmut Dac' Kalis!

VARGJE MAJËKRAHU

Në Tropojë boçet e gështenjave plas in nga malli
E si në lojë fëmijësh bien në Valbonë,
Plasin nga malli, nga pjekja, nga zjarri
Megjithëse është vjeshtë, megjithëse është vonë.

Plasin boçet me gjëmbe si iriqi,
Valbona si një rimë, Valbona si rrëfenjë,
Dridhet në luginë veç një shall i kaltër
Mua syri yt më plas si gështenjë.

Në shtegun e Valbonës ngritur kam pusinë,
Djegur si një prush, tretur si jaran.
Me nazet si Shotë, me hiret si Zanë
Si hënë e stolisur me flori në ballë.

DETI JON

Kadife e kaltër që valëvitet nga era
Mëndafsh për shtrat sirenash,
Krahun, gjithë muskuj me damarë burri
E zhyt në det Karaburuni...

I joni deti Jon,
Tonat sirenat,
Që i luajnë syrin kurbanit,
Tastiera e valëve e trokthi i zemrës
Ngrihen e ulen si gjoksi i labit.

E unë,
Mend luaj nga bukuria
I mekur, pa fjalë nga hijeshia
Para kadife e kaltër-
Fustanellë me pala malesh
Mbi supe Labëria.

FLETORE DETYRASH

Fletore detyrash Atdheu
Me vija të gjera,
Me vija katrore,
Paralele e drejtëza,
Ku shkruaj ABC -në
Pastaj hartime e vjersha.

Pastaj një krah,
Një sqep,
Një arush,
Një ketër,
Një ditë që ecën,
Një natë që fle;
Një shqiponjë,
Një fushë të kuqe,
Një shpirt të dëlirë,
Një fole në kreshta.

...Në fletoren e Atdheut
Një fletë zhubros vjeshta.

PEJË, PRANVERË 2016

Gryka e Rugovës mbledh retë e qiellit,
Lotët e dhimbjes,
E bëhet pash më pash një lum,
Lumi me valë lidh plagët,
E më sjell të rënët e të gjallët,
Me shpirt e me kurm.

Valon në Rrafsh të Dukagjinit
Shalli i Rugovës,
Buron në gurrat e bjeshkëve
Liria e Kosovës!

Ka shkrirë dëbora në Pejë,
Ka buisur tej e tej gjelbërimi...

PJERGULLA

I ngjitet avllisë pjergulla
Si rreze mëngjesi,
Si gjurma e udhës,
Tinëz, si vjetulla;

Pjergulla shkund gjethet në vjeshtë
Si gjyshja sarginë e leshtë.

Në dimër,
Gishtat e mi me morth
As lëkura e deles nuk i ngroh.

GJITHÇKA JAM ...

Unë jam gladiatori romak
Dhe Uliksi dinak,
Rikard zemërluan
Dhe Aleksandri i Madh,
Disi Skënderbe,
Car e Xhingis Kan,

Sulejman i Madhërishëm jam,
Kutuzov e Napoleon;
Jam Nastradin që botën vë në gisht,
Leva e Arkimedit që rruzullin përmbys,
Fari dhe Biblioteka e Aleksandrisë,
Shkrim i lashtë kinez
Dhe kopshtet e varura të Babilonisë.

Jam actek, pellazg, arab, rom, cigan, indian
Në racë e në farë,
Homosapiens nga balta e me baltën
Nga shiu për ujin,
Nga era për ajrin,
Nga hiri për zjarrin,
Jam heshtë me strall
Shpatë, barot, plumb,
Intrigë, tradhti, dashuri, fëmijëri, burrëri,
Udhë, rrokje, fjalë, rrënjë, lëkurë, trung.

Jam fuqia universale e atomit,
Virusi, përgjimi, tortura, burgu,
Lajka, habia, trishtimi,
Fobia, bukuria, makutëria, fisnikëria.

Jam fara dhe bima,
Jam lulja dhe fruti,
Jam tërfili dhe pluhuri,
Vala dhe orteku
Jam shkatërrimi,
Ndërtimi,
Lindja
Dhe vdekja,
E djeshmja,
E sotmja,
E nesërmja.

E ç'mund të jem tjetër?
Jam pika dhe presja.

PREKAZ, QERSHOR 2016

- 59 të rënëve të familjes Jashari -

Në luginën e Prekazit bie shi
Shi i imët, si lot - kristal,
Është pranverë, qielli prapë se prapë gri;
Mijëra njerëz, varg në funeral...

Në pesëdhjetenëntë varre, mermer skalitur,
Në pesëdhjetenëntë shtiza, flamuj valëvitur,
E pesëdhjetenëntë pash lisat janë rritur,
E pesëdhjetenëntë male përqark janë ngritur;

Pastaj:

Në pesëdhjetenëntë ditë dashuri që priten,
Në pesëdhjetenëntë muaj ëndrrat që shkrihen,
Në pesëdhjetenëntë mote toka që tronditet,
Në pesëdhjetenëntë emra, yje që skaliten...

Pastaj,

Përmes shiut
Rrebesh me plumba zjarri,
Rrufetë si Zeusi
I pret Adem Jashari...

KAM ËNDËRRUAR

Kam ëndërruar të jem një lepur,
Jo nga frika e një të porsalinduri,
Por për butësinë e shpirtit,
E sytë si vesë të një të pafajshmi.

Kam ëndërruar të jem një kalë
Jo për fuqinë e kurrizit,
Por për besnikërinë ndaj të zotit,
Si shiu i majit për tokën...

Kam ëndërruar të bëhem hije rrapi,
Jo për vetminë e udhës që merr mërgata,
Por për freskinë e mendimit
Në kryqëzimin e rrufeve, që sjell shtrëngata.

Kam ëndërruar të jem hoje mjalti
Për një vdekje të paqtë...

11

Zemra ime që kurrë
s'e kam parë

PËRSËRI PËR SHIUN

Mua më pëlqen shiu
I imtë si miell,
I shtruar si kau;
Me gishtat në fyell.

Mua më cyt shiu
Të luaj si fëmi,
I thellë si filozof,
Marrosur për ty.

Më pëlqen shiu
Dhe kur s'kam një çadër
Dhe kur s'kam një strehëz
Dhe kur s'kam një vatër.

Ballin mbështes në xham
Pikturoj me mollëza gishtash
Një udhë për te ty
Me ngjyra ylberi.

Sigurisht, e dashur, pas shiut...

STRESI

Pikon i gjelbërt si loti i pjergullës
E shpirtin ma gërryen si acari në mars,
E lëmuar pasqyra e syve të mi
Brenda,
Përroi i stresit më gërryen gjithë maraz...

DËSHIRË FIKSE

Paskam dëshirë të rri në shi
Në brinjë të shkrihem si bora,
Si kripa kur nëna u hedh groshëve
E kokrrat i shtyp me mollëza.

Të qullem sot seç kam dëshirë
Në mish, në kocka e në shpirtra;
Siç qullet brumi që ngjesh nëna
Kur bukën zë pa zbardhur drita.

Të qullem siç qull babai cigaren
Me buzët tharë si eshkë,
Në kurthe strehësh le të mbetem
Siç rri bariu me gunë në vjeshtë.

Ky trill, kjo tekë këtë maj
Në trupin tim bën tatuazhe,
E qesh e luaj pllaq-plluq në ujë
Siç luan udha në mirazhe...

NDJENJË E TURBULLT

Të ndjeva pranë, moj mike,
megjithëse me mote larg,
Ti në vendlindjen e zogjve,
Unë me perëndimin në lak.

Në lakun që më mbyt në fyt
I huaj mes pëllumbash si korb,
Nuk di as gjuhë e zakone
Nuk di as trend e as modë.

Në mes kësaj katrahure
Me ty jam gjithsesi,
Dhe qesh se qeshin të tjerët
Gjithë koti, me mallin përbri.

Pa vlerë e sens refugjati
Si rekruti malësor ne repart,
Unë ngrihem, eci ditë-netëve
Drejt teje i djegur turravrap.

E fryma më merret nga lodhja
Nga malli një ngërç në zemër,
S'e di, nëse pa ty planetet
Do të kishin të njëjtin emër.

KËNGA

Nis si udhë
Nga shtëpia drejt pyllit me gështenja,
Me qindra dashuri,
Me mijëra rrëfenja,
Tendosur në sharki,
Në telat e zemrës...

Pastaj fluturon me mëllenjat
E pëlhurë e bën lumin,
E shaminë e nënës
Shtëpizë për pëllumbin.

NDARË...

Ne u grindëm, siç grindet era me brinjën,
Ne u pajtuam, siç pajtohet përroi me lumin
Pastaj vazhduam udhën,
Si pëllumbesha me pëllumbin.

Ndarë, por çuditërisht jemi bashkë,
Bashkë, por çuditërisht të ndarë,
Siç është Udhë e Qumështit në qiellin pa fund,
Si sinori nga shirat në një anë.

Të ndjej përtej vetes, përtej vështimit,
Përtej shpresës, përtej tundimit,
Akoma më tej ndjenjës së amëshimit
Përtej, përtej, krejt përtej flijimit.

Ndaras nisemi të derdhemi në det,
Por brenga s'na ndan,
As vala s'na tret.

PA TITULL

Ishim bashkë
Dhe mendonim se gjer në fund të udhës
të ishim bashkë.
Harronim dimrin e egër,
Harronim verën e thatë.

Tani nuk jemi bashkë
Në pranvera e në vjeshta.
Një urë ndërtuam dikur,
Që lidhi brigje e kreshta...

Dhe ishim njëherë bashkë...

NJERËZIT KËRMIJ

Njerëzit e vegjël janë si kërmijtë
Që zvarriten e lëshojnë jargë,
Jargë nëpër mure, gurë e tërfil
Në hardhi, ferra, gjer poshtë në hajat.

Çudi me njerëzit kërmij
Të vegjël, të mbrojtur me guaska,
E gjuajnë çastin e bunacës
Të sulen pas lëmshit në gracka.

Por unë jam përtej tyre
Jashtë pellgut, jashtë bunacës
Duke pritur trokitjen njerëzore
Prapë, e përsëri përtej guaskës...

PAK VARGJE PËR DELET

Si lule zambaku shpërndarë në livadh
Të urta, sqimatare, bujare pa cak,
Dridhem e tremem për një fije bari,
Për delet një dyzinë s'më dhimbsen aspak.

E mrekullohem kur kthehen në mbrëmje,
Si rruazat në mëndafsh të lidhura në qafë,
Tërfilin do ta kthejnë në qumësht,
Si alkimiste veshur me bluzën e bardhë.

E SHKRUAR PËR VDEKJEN

- *Varianti i parë* -

Me vdekjen ecim çdo ditë e natë,
Trup e hije, gjithnjë bashkë,
Sa harrojmë se jemi kaq pranë,
Kaq pranë miq, armiq kaq larg!

Pa e takuar, pa folur sy më sy,
E largojmë, e përzëmë përjetësisht,
Por na ndjek një skile e përbotshme
Si mace e zezë, tinëzisht.

Ecim. E urrejmë njëri-tjetrin,
Siç urrente Pilati një Krisht,
E bukur jeta është me lindjen,
Pa perëndim s'ka lindje, sigurisht.

- Varianti i dytë -

E urrej aq shumë vdekjen,
Por ngushtas eci me të ngado,
Sapo urdhri të zbresë nga qielli
Në zhgjëndërr, e dashur, mos më kërko!

Ecim. Urrejmë njëri-tjetrin,
Ndonëse ngushtas ecim pranë e pranë,
Një ditë kur s'do më shihni në udhë,
Kam ikur në botën pa fund e pa anë.

S'takohemi kurrë. Mendojmë, flasim,
Të shkuarën largojmë. Presim çastin.
Thoni çfarë të mundeni pastaj për mua,
Shkruajeni si të doni epitafin!

Kështu pat thënë Platoni
Tek Apologjia e pavdekshme e Sokratit...

MIGJENI MË SFIDOI MBRËMË

Migjeni më sfidoi mbrëmë...

Se si e nisëm bisedën nuk e kujtoj,
Në inbox më shkroi ai i pari,
Iu përgjigja me mburrje njëfarësoj.

Njëfarësoj për të qenë pak modest,
Për kohët moderne në delir dhe mall,
Ai ikte, Ai zbriste, Ai ngjitej e habiste
Me “Kanga e dhimbës krenare” si hamall.

“Lulin e vocërr” në rrugë e gjen më tha,
Dhe “Moll e ndalueme” farmak në gojë!
Një kokërr misër shkela mbrëmë në ëndërr,
T’ shitoftë Zana! Lanet, njëfarësoj!

E trishtueshme nata, i mpirë Migjeni,
E kolla e thatë si gjarpri në lojë...
A don qymyr zotni, e ndrojtur malësorja,
A don qymyr... nderin - njëfarësoj.

Nuk munda Migjenin. Koha ime më munda,
U trishtova dhe heshta krejt në vaj,
Kollitej stërdhëmbësh tuberkulozi,
Dhe rrudhat e vuajtjes pa formë e pa skaj.

Kapërceva pragun, në zhgjëndërr, në ëndërr,
Një shkretimë apo krismë më zgjoi,
Siluetë e Migjenit largohej në ag,
Në ag, në udhën e qiellit njëfarësoj.

Me Migjenin isha. Me Migjenin jam,
Smartphone-in s'e kisha ndër sy aspak,
Kur do soset e tretet kjo natë,
Të zgjohem nga ky makth e të iki larg!

E MOÇME

Në një parmendë
Kau i ri me kaun plak
Shtrembëronin vithet
Nga shkopi i të zotit
I rëndë dhe i thatë.

Kau plak nuk kishte fuqi,
Shtirej i paditur kau i ri.

DHE GJUMI IKËN

Iku gjumi si një ketër
Si një zog degë më degë,
Buzë e mollëza kuq të çelur
Çelur, plasur si një shegë!

Iku gjumi si burimi
Nëpër gjethe, nëpër gurë,
U këput një yll në palmë
Palma, palmë vjen tek unë.

Iku gjumi bashkë me natën
E të ndoqa nëpër ag,
Si pulëbardhë i ngjitesh valës,
Zhytesh valësh e s'të lag.

Iku gjumi si një ketër
Trung më trung e syth më syth,
Brodhëm botën të dy bashkë
Nëpër yje plis më plis.

E u shkrimë, u vrerosëm,
Larg e pranë në shteg, pa shteg
Një rrebesh i ardh' nga qielli
Ra ylberi e u tret...

ÇAST

Fryn një erë e fortë
Dhe po shkunden yjet,
Qielli mbeti bosh
Bie dhe nuk ngrihet!

ETYD

Fustani i kaltër ku derdhej bishtaleci
S'më hiqet nga mendja,
Vitet kanë kaluar, zemra e trazuar,
Rrëmet është përbrenda.

Sa herë bie shi, pjergulla në udhë
Thur bishtaleca,
Dashurinë për ty, katakomb në lukth
Kurrë nuk e treta!

Qenka e pamundur, nuk qenka e thënë
Të mbledh pika shiu!
Pëllëmbët nuk binden që të bëhen grusht
Kallkan nga veriu!

PRITJA

Të kam pritur
Në fund të rrugicës
Që fshihej disi nga syri i botës,
E hënëza krekosej
Si thithkat e sisës.

Aty pari gjithçka u megjullua,
U ngjitëm të dy si mishi me thua...
Yjet, si gratë,
Sehir bënin me mua.

Hëna vishej me fustan prej basme
Me reçipeta të mëndafshta,
Nën shelgje fshihej si bukëls me gjasme,
E shkrihej si bora në rrasa.

Thjeshtë, ky fund i rrugicës
Si thithka e sisës!

TRILL I HERSHËM

Zemrat janë prej mishi, mike e shtrenjtë,
Tik-taket janë fjalë
Që përshpërit shiu në livadhin e tharë.

Gjaku është prej shiu, mike e shtrenjtë
Që bie sa herë ti me sheh vëngër;
Nga banka e dytë në rreshtin nga dritaret.

Sytë janë gjithçka, mike e shtrenjtë,
Zemra, gjaku, mishi, eshtrat, mollëzat e të tjera
Janë thesaret.

CELULARI

Kujtoj centralistin Xan
Hiq e ve fishën në tastierë.
Xani më ngjante krejt enigmatik,
Enigmatik dhe çudibërës,
Një kohë e një herë.

Tani me celularin në dorë
Nuk e jetoj atë çast magjik,
Kur në gishtat e centralistit Xan
Bota vërtitej si majmun në cirk.

Celularin do ta flak tej shpatit matan'
Sapo të zgjohet nga gjumi i përtej botës
Centralisti Xan.

I MALLUAR, I DJEGUR

Aty ku udha merr formë bërryli
Me sy të malluar po të pres,
Mëndafsh i erës në buzë dridhet
Si varg me rimë ku endet një shpresë.

Ja më në fund buron e shfaqesh
Si një sirenë që vjen nga larg,
Ngrihet, ulet gjoksi yt, e dashur,
Si kurmi i një hëne që del në Dajt.

S'e di ç'po ndodh me ty - ma thuaj,
Ç'po ndodh me mua nuk e di,
Çdo çast brenda meje më bën të vuaj,
Më duken mote kur jam pa ty.

Të puth me afsh si prushi flakën
Në gjoksin tënd unë paqe ndjej,
Dhe mbyllem aty në terrin e natës,
Gjersa diellin sërish të ta kthej.

PËR TEK TI

Udhën e shkurtër kam zgjedhur
Për të ardhur tek ti;
Udhën e gjatë për t'u ngjitur në qiell;
Si një fije peri
E bërë tërkuzë
Lidhur në fund me njëqind yje
Për foletë e zogjve;

E nisëm për tek ti
Në udhë e pa udhë...

FËMIJËRI

Udhështruar me gjurmë udhëtarësh,
Këmbë e duar zgjaten përtej lindjes,
Ku duken brinjët e maleve.

Pastaj si në kolonë ecim drejt shkollës
Për të hyrë në klasa,
Me libra, fletore e lapsa
Të heshtur si germat,
Të zhurmshëm si fjala.

Fëmijëria jonë,
Mendim i pathënë,
Me germa të mbetura,
Si guralecë ndër dhëmbë.

ABSTRAKSION

Buzë të kuqe?

Jo. Lulëkuqe në fushë si rreshpe;

Udhë me njerëz?

Jo. Ca gjethe të rëna në gishta vjeshte;

Çerdhe zogjsh?

Jo. Qeleshe malësori ulur mbi sy;

Re në qiell?

Jo. Ca zogj me krahë e ëndrra gri;

Bunacë deti?

Jo. Gjoksi i vajzës valë-valë;

Diell që bie?

Jo. Shpirti im që digjet zjarr!

Çfarë ka mbetur?

Janë sekrete, miq të dashur,

Është mall.

ADOLESHENCË

Nën sqetullën e rrugicës
Si foleja e qyqes,
Strukur nga syri i botës
Në lagunë të gjoksit.

Ti me fustan basme
Me sy të mëndafshta,
Më fshihesh me gjasme
Si bora ndër rrasa.

Gjithçka m'u mjergullua
M'u nda mish e thua,
Në lugun mes gjinjve
Si bora më shkrive!

Mendja seç më iku
Më iku, më fiku!

PËR TY

Engjëjt janë pa formë e pa trajtë, mikja ime;
As në ëndërr e në zhgjëndërr s'i kam parë,
Por Engjëjt janë Engjëj, mikja ime,
Po i nis drejt teje,
T'i kesh sa më pranë...

ËNDËRR...

Në ëndërr pashë një fushë plot luledele
E qingja që kërcenin si mbi susta bari,
Gjer lart në pisha e në kupë të qiellit
Lëkundej hareja tamam si i marri.

Unë zgjuar mbeta deri në të gdhirë
Te grigjat dhe shtegun që pret,
Mos vinin ujqërit për luledelet
Dhe qingjat m'i rrëmbenin, medet!

FJALA

Mendoje, bluaje fjalën,
Përtype si mokra grurin,
Si toka që përtyp farën,
Që mbin e lidh frutin.

Fjala, shkëmb i rëndë,
Fjala, si gur varri,
Fjala, kob e thesar,
Si flakë e prush zjarri.

E fjala nis puhizë,
Që ngroh e lidh brigje,
Por bëhet uragan,
Që shemb e mbyll shtigje.

Një fjalë është legjendë,
Një jetë brez pas brezi,
Fjala pushtoi zemra,
Fjala luftëra ndezi.

Fjala!

MOTIVE NË SHI

Unë e kam mik shiun,
Shiun që njom qerpikun e strehëzës,
Që zbut tokën e zhuritur
Larg, shumë larg harresës.

I marrosur jam pas shiut
Me pikëzat dhe rrëkezat,
Kur lodhja më ka këputur gjurin
E zogjtë tregojnë gjëgjëzat.

E në strehë kur varet shiu
Në sokaqe gjithandej,
Puthur, ndukur, përqafuar,
Flokësh lagur tejpërtej.

Nën pika shiu, vetulla strehësh
Ndahemi siç ndahen dashnorët,
Ky shiu është kaq i bekuar,
Më lag, më fshin sinoret...

DHE VITET IKIN...

Në sytë e mi rrathët e moshës
Disi mavi, tkurrur nga vitet;
kërrusur nga halli, nga puna e stresi,
Si valët e lumit që brigjeve priten.

S'jam trung i prerë nyje në brinjë,
As lis i djegur nga rrufeja në vjeshtë,
Jam në udhë-hije udhëtarësh
Dhe strall i gjallë, i mbirë në kreshtë.

Midis dy shpateve, në llërë burimesh
Aty ku ylberi kapërcen ylberin,
Sytë e mi me rrathët e moshës,
Lidhur si kulmi me themelin.

Kam kaluar shpate e përrenj,
E jam përshëndetur me zogjtë në udhë,
Shpirti im s'u tremb nga një kollë,
Balli im s'u step nga një rrudhë!

...S'jam trung i prerë nga rrathët e viteve
Jam një zgalem i paepur në udhë....

KARSHI PËR KARSHI

Si dy shtigje mali
Gërshetat në shtat,
Lidhur kalli gruri
Të buta mëndafsh.

Aty derdhet hëna
Dielli lind aty,
Si dy brigje lumi
Karshi për karshi.

Aty syri, malli,
Ëndrra gjithsesi,
Si dy maja malesh
Karshi për karshi.

Lidh e zgjidh gërshetat
Ne ecim përbri,
Si dy lule maji
Karshi për karshi.

Aty tretet bora
Dhe lotët në sy,
Të dy përvëlur
Karshi për karshi.

DETI I MOSHËS

Burimi i moshës
I pakët, i fshehur
Nën gjethe lajthie,
Nën hije ahu,
Si tinguj sharkie
Syrin ia luan diellit,
Mahi i bën hënës,
Përulet e pi sisë
Në gjirin e nënës;
E rrjedh në pëllëmbë
Shelgjeve të zallit,
Vrimave të fyellit,
Zjarrit të jaranit!

Mblidhen rrëkezat
E bëhen përrua,
Me këmbë të zbathura
Manar e dragua!
Me thonj të paprerë,
Me gishta të vrarë,
Me gjunj të nxirë
Adoleshent i marrë!

Pastaj,
Mirazhe në rrugë treten,
Si një mbretëreshë
Në zgjua
Mbledh bletën.

Derdhet përroi i moshës
Si rrëkezë në lumë,
E lumi laton shtratin
Me valëz, me shkumë.

Hap shtigje, qafa, pragje,
Fryhet e krekoset
Gjersa poshtë në fushë
Si kau qetësohet.

Lahem në Detin e Moshës
As krejt i ri,
Por kurrë i plakur.
E nga dashuria
Aspak i flakur!

Kthej sytë nga deti
Hapat nga udhët,
Krahët nga gjurmët;
Një fjalë do të jem
E për kthim nuk tundem.

E prapë, miq të mi,
Të iki prej vetes
Sinqerisht,
Nuk mundem...

VJESHTA

Po shkund degët gjyshja Vjeshtë
Nëpër erë e nëpër shi,
Udha e gjyshes është e verdhë,
Udha e reve krejt në gri.

Një nga një i zbret shkallët,
Me nallane zgjon sokaqet,
Reumatizma ia mpin këmbët
Një frulliz i mpin dhëmballët.

Lidh shaminë gjyshja Vjeshtë
Nëpër degë e nëpër erë,
Gjyshi Dimër vë qeleshen
Mbi Korab, Gjallicë e Dejë.

Kujtimi yt mërdhi e ngrin,
Rend me Vjeshtën në sokaqe,
Ku e ku është hidhërimi,
Me kollë dimri në oxhaqe.

Se vjen Dimri me potere
Hijerëndë e sevdalli
Poshtë në zall struken shelgjet
Korabi qeleshen mbi sy!

MALL

Mall i largët, mall i djegur
Si një prush në hi mbuluar,
Në një shelg anës përroit
Jam me ty i përqaftuar.

Pak i djegur, shumë i malluar,
Dhe i afërt, shumë i largët,
Lidhur shelgjesh si një nyje
Ti si hëna nëpër yje.

Ikën, vjen, erë në stinë
Nëpër lule, në burime,
Si trokitje nëpër xhama
Drithërimë në zemrën time.

Si ngadalë, si në të ngutur
Nëpër ditë e nëpër natë,
Malli i largët i plagosur
Zverdh në degë si gjeth' i thatë.

Po si ikën këto mote
Gjith' këtë kohë më s'u pamë!
Puthje, lot i ranë shelgut,
I ranë shelgut dhe e thanë!

BALADË

Na u ngrit dikush nga varri
Varrin hapur kishin parë.
Ishte larë e ishte veshur
Plagët era ia kish' tharë.

Kish kaluar Kish'n e Vjetër
Dhe sinjale kishte dhënë;
Ishte ftohtë – natë e errët
Hëna yjet kishte ngrënë.

Por kish sytë që shponin natën
E veç natës bënin dritë,
U afrua pranë dritares
Me një zemër copë e çikë.

Mbyllur perdet e dritares,
Portë e panjës mbyllur ish;
Hesht i trembur plep i moçëm,
Udha shkretë si një dervish.

E kish dashur gjer në varr
Gjer në shpirt që s'ka të vdekur,
Ndaj dhe nata pus e thellë
Rrasat varrit ia kish hequr.

Por kish humbur bukuria
Dhe sinjalet ikën, vanë,
Gurë e baltë e plisa dheu
Prapë përsipër rëndë ranë...

Zhveshi rrobat e jaranit,
Njomi plagët, thau sytë,
E bekoi si një i vdekur:
“Mike natën e paç dritë!”

RIMA NË DIMËR

Rimë, vargje po shkund nata
Porsi gjethet nëpër vjeshtë,
Dhe pak fat në jetë u dashka
Dhe në shteg një dor' e lehtë.

Kur në lukth të zë pikëllimi
Ngërçi, bryma gishtat mpin,
Ngrirë mëlljenja nga thëllimi
Mekur, ndrydhur shpirti im.

Zbresin ujqërit në turm' kope
Nëpër borë, në udhë pa udhë;
Ngrin nga frika dhia plle,
Sytë bën katër delja rudë.

Atëherë kur një krism' arme
E shpon natën tej për tej,
Si një mbret gërhet ky dimër
Putra, gjurmë gjithandej.

S'ka si dimri kur ke zjarrin,
Bardhësi pa fund e anë;
S'ka si jeta kur ngroh mallin,
S'ka si mikja që ke pranë.

PËRSËRI NË ËNDËRR

Asnjëherë s'më ke ardhur në ëndërr si këtë natë janari.
Trokite me flokët ngjitur në ballë si fije bari;
Shkreptimat - kërcitje kockash, binin e vinin nga qielli,
Më kot, nuk ndizej zjarri!

Ne ishim bashkë.
Frikë nuk kishim as nga shejtani e as nga lugati.
Isha në ëndërr.
Çizmet më mbetën në dëborë dhe ecja këmbëzbathur;
Kisha ftohtë.
Kisha frikë se kupa e qiellit do të plaste
 Si lëkura e gjarprit;
Ndaj të mbështolla me trikon time të leshtë.
E ndeza një zjarr në zemër,
E prapë kisha ankth se do të ngrish në gardhin e natës
 Në pragun e derës si një lule marsi.
Dhe të mbështolla me shpirtin.

Kur u zgjova
Isha zbuluar nga kujdesi për ty.
Pastaj hyri nëna si Hirushe
E na mbuloi me një velenxë të artë
Të dy...

KULUMBRITË

Kur çelin kulumbritë
Me të bardha vishen udhët,
Harabel' e zogj të tjerë
Me të kuq i lyejnë buzët.

Në oborre dalin gjyshet,
Mbledhin thinjat në shami;
Herë si ninullë, herë ofshamë
Mërmërit ky Drin i Zi.

Dallëndyshet seç vallëzojnë,
Në tel erë e temperuar;
Shpat' e brinjë, livadh e gërxhë
Me jeshile nusëruar.

Në balluke floku i vajzës
Kuturis me kulumbritë,
Gjoks i kolm' si plloç dëbore
Jo mësysh, - të plaçin sytë!!

ZJARRMIA

Përbrenda digjet lisi
Ku ngroh duart gjithë akull nata e dimrit.

Për të ngrohur shpirtin
Bëhemi bashkë një trup
Si prushi me hirin...

KUR JAM VETËM

Lidha duart si dy duaj gruri
E mbështeta kryet
Në jastëkun me re të murrme;

Pastaj mbylla sytë
Dhe shkrepitima qepallat m'i nduk;

Kërkoja vetminë
Dhe një shi të paqtë
Për sytë e mi.

IKJA

Ikën zogjtë nga foletë e pyllit,
Ikën pëllumbat nga shpirti im,
I fundit, miq, do të iki dhe unë,
Për ju po lë një degë ulliri.

Një degë ulliri, një degë dafine,
Për sytë e zemrat që mbeten pas.

PRANVERA ERDHI

Eja,
Lulet e qershisë të bukura janë,
Të bardha janë,
Si flokë bore janë
E si shpirti yt janë.

Nuk është dimër, e dashur,
Është pranverë;
Kanë çelur qershitë
E me bletët po mbledh nektarin.
Nektarin, në hoje mbretëreshe!

III

Çmendet ftoi nga e verdha

ATËHERË

Kuçedra vjell zjarr si oxhaku
Për ta qetësuar nëna pjek gështenja;
Ëndrrat e mia si slita mbi dëborë,
Veshur me opinga si rrëfenja.

Nuk dihet ku do të ndalet trupi im i brishtë
E kolla e mirë mund të shembë ortiqet,
Në majën e Korabit jastëkun kam vënë,
Në lumin Drin kam shtruar postiqet.

Fëmijëria ime rri në prag të derës
E ngrohet si kone në diellin e marsit,
Del në udhë, ku krahët hapin kulumbritë,
E rri në qoshe, ku miu fshihet prej dacist.

Ëndrrat e mia slita mbi dëborë,
Veshur me opinga si rrëfenja...

BISEDË E VONË ME TY

Sytë e mi me mavinë e moshës
Të tkurrur si shkronja,
Të lidhura si fjalë
Zbresin në mollëza,
Ngjiten në ballë
Si rrudha të rralla,
Si në përralla.

Zemra ime
Që kurrë s'e kam parë
Me aortë sa Drini,
Me përrenj - damarë
S'lodhet së punuari
As së dashuruari!

Krejt si të marrë!

KTHIM NË FËMIJËRI

Trumcaku më zgjoi nga gjumi
Mbështetur mbi xham i mardhur, i mpirë,
Tak-tak në akullin transparent të qelqit,
Tik-tak ora e shkollës si një grifshë e ngrirë.

Nëna krejt pa mendje në punët e mëngjesit,
Babai në udhët e largëta të nëntokës,
Sqepi i trumcakut thyhet pas xhamit,
Akrepat e orës si shemrat për flokësh!

Tak-tak, tak-tak sqepi i trumcakut,
Tik-tak, tak-tik akrepat e orës,
Thyhen copë e çikë tej pragut,
Si shkoza e kërrusur nga rrebesh i borës...

VARGJE NË UDHË

(Poemë)

Herë krah i shtrirë burri,
Herë bërryl i vrarë djali,
Herë qafë e thyer kau,
Herë krelë hazdisur kali.

Me sy e zemër dhjetëra vjet,
Qindra vjet me përshëndetje,
Mijëra vjet të fshehta, brengë,
Mijëra vjet me amanete.

Eh, kjo udhë s'paska të sosur,
Nëpër male, në fushë, luginë
Nëpër gjurmët e stërgjyshërve,
Nëpër erë, suferinë.

Dhe i shoh të gjitha udhët
Që nga udha e fshatit tim,
Ja një shteg që zbret zabelit,
Gjurmë nizami ngrin e nxin...

Emra, fjalë luftëtarësh,
Anonimë kaçakë, komitë
Poshtë burimit, poshtë lajthisë
Lak e tinëz bëjnë pritë.

E menduar tirret udha
Në mendime jam dhe unë,
Gjurmë pas mbetën me qindra
Dhe përpara mijëra gjurmë.

Ja një rrugë dhishë që jepet
Si kothere në shpat, matanë,
E si plaka rrudhen gjethet
Mbetur degëve si nishan.

*

Eci, eci e nuk ndalem
Udhë e gjatë e udhë prapë
Fushë, kodër, mal kalova
Përballë meje prapë një shpat...

Veç një shpat e një kodrinë
Një kodrinë e bërë prej dheu,
Epitafi krejt pa rimë
Si penel që era theu...

Udhët plot me tungjatjeta
Plak i urtë e djalë ashik
Dhe një ndezje e cigares
Më ngroh sytë e më bën mik.

Se kështu ecin udhët
Nëpër mote, nëpër shekuj,
Nuk i ndryshk shiu i vjeshtës,
As acar, as mall i mbetur.

*

Gjaku udhë ka damarët
Dhe mendimi udhë e gjurmë,
Dhe tik-taku i zemrës tënde,
Dhe një puthje buzë më buzë.

Dhe një jakë që ma kthen nëna
Me kujdes, me fije bari,
Dhe një varg me dallëndyshe
Me padjeshka në rrugë ajri.

Dhe një plug që tërheq kau
Nëpër tokën tërë vlagë,
Një hardhi që ngjitet lisit
Janë udhë që ngjiten lart.

Varg si udhë milingonash
Edhe ujqërish në dëborë,
Në udhë zbresin, në udhë ngjiten
Hallexhinjë edhe dasmorë.

*

Bie, ngrihem nëpër udhë,
Nëpër shqotë e nëpër erë,
Veshur, ngjeshur jam në dimër
Krejt si gjethi në pranverë.

Atje nisa, këtu erdha,
Udhë, udhë e udhë sërish
Fishkëlleva e këndova
Dhe kam heshtur si dervish.

Dhe me bërryl më shtynë në udhë,
Me stërkëmbështa si akrepa,
Jam rrëzuar, jam ringritur
Krejt me plagë, por prapë eca...

Se jam mbajtur, se më mbajtën
Shokët, miqtë që kisha pranë,
Derdimenët thyen kokat,
Ziliqarë e shpirtkatranë.

*

Në udhë jam, ju përshëndes,
Si një mik e shok i mirë,
“Tungjatjeta”!, një urim
Shpirt e zemër krejt i dëlirë.

Jetë më jepni në çdo shteg,
Forcë, kurajo edhe shpresë,
Pa ju, pa ne, pa erë e gjeth',
Kish' me qenë udha e shkretë.

Pa gjurmë udha nuk ka vlerë
As emri im nuk ka kuptim,
Se nuk jam boshi në hënë
As ju boshllëku pa mbarim.

Në udhë lufton jeta me vdekjen,
Vdesim një ditë e lindim sërish,
Nën një tyrbe apo në xhami,
Sinagogë apo një kishë.

Udhë lashë e udhë kam prapë
Nëpër ditë e nëpër stinë,
Me vështrimin diku larg,
Që ta njoh më mirë njerinë.

KALËRON DRINI I ZI

(Poemë)

Tel sharkie Drini i Zi
Temperohet buzë Strugës,
Mbi nëntë male, me nëntë krushq
Si një zanë zbret në Kukës.

Herë si zanë, herë si gjyshe
Lidh e zgjidh shaminë si shkronjë,
Pranverë, vjeshtë grua shtatzënë
Dimër, verë si një lehonë.

Dibër e Madhe, Luzni e Muhurr,
Fushë Alie, Dardh e Reç;
Kalëron në fushë e male! -
“Plast’ si krypa Syri i Keq!”

Kalëron si një dori
Si doriu kuq e zi,
Që mbledh zalle e përrenj,
Siç mbledh flaka prush dhe hi.

Çelet porta në Miresh,
Një dritare në Skavicë,
Vala jote magjiplotë
Edhe terrin e bën dritë.

Vala jote si një ninullë
Si një gjeth' e si një fjalë,
Tungjatjeta është në udhë
Besë e nder e faqebardhë!

Zall-Sopot, Murrë e Mallë,
Bicaj, Luma, Veleshicë,
Zbresin si qingjat manar,
Në gjunjë ulen e pijnë sisë.

Velivar, Korab, Gjalicë
Runjë, Kurorë, Lajthizë e Dhoks
Roje rrinë nëpër bedena
Ndaj dhe nata s'të terr dot.

Jetë e dritë magjiplotë
Vala jote krejt flori,
Lum si ti nuk paskam parë,
Kaq bujar, i lumi ti!

Ngrihet' ulet vala jote
Kurmi yt një simfoni!
Herë si ninullë përkund djepa,
Herë ciklopi me një sy!

*

Në kanata vizatimi
Pikturoj Drinin e Zi
Valë ëndrrash mbledh në grushta
Kodra, male ngjyrë gri.

Ja një prehër, dorë nëne
Dhe një ëndërr e një vajzë,
Ja një fjalë mirësie
E në gjoks çelur një plagë!

Ja një re, një shkretimë,
Një shi vjeshte, një rrasë varri,
E një letër krejt e zverdhur
Zverdhur, djegur nga nizami.

Ja pëllumbi, pëllumbesha
Nduken, puthen gjithë zjarrmi!
E në brigje pikon streha,
Streha ime veç për ty!

Kur në valle dredh shaminë
Dhe qeleshen hedh mbi sy,
Dhëndërr shik dhe i qeshur
Nur e gaz ky Drini i Zi!

Dhëndërr, nuse për konak
Ngjeshur mes dy vargmalesh,
Si jaran nuk ka të dytë
Sarahoshi në mes valësh!

Vjen si ëndërr, shtojzovalle,
Erë puhizë e fllad lëndine,
Thur çorape e sargi,
Si një mall për nënën time!

Për mua jelek dhënduri,
Për motrën vello ari,
Për të mbjellat ujë si qumësht
E për gjyshin një plis varri!

E për shokë, shtegtarë dhe miq
Derdhesh, shkrihesh si sheqeri
Nëpër male, nëpër fusha
Me shtatë ngjyra si ylberi.

*

Që kur linda e u rrita
U përkunda bashkë me ty,
Nëpër shtigje, nëpër zalle
Gjith' me afsh e dashuri.

Ngrihem, eci, ulem shkruaj,
Të dy bashkë si dy sozi,
Jam i bëri, jam i tëri,
Hem djalosh, hem Drin i Zi.

Kulla ime shelg përkulet
Udha ime në pasqyrë,
Mbyllet qielli si qepalla,
Si qepalla që fsheh synë.

E kur shkruaj dy gisht letër
Për një brengë e për një mall,
Nis rrëfhem për mëkatet
Dhe pse lindur mysliman.

*

Djep kreshnikësh Drini i Zi
Djep e shpatë e Skënderbeut,
Me një hir të zjarrtë si dielli
Kënde, andej e matanë dheut.

Për liri e për vatan
Si vullkan e zjarr shpërtheu,
Si bajrak e flakadan
Matanë, andej e këndej dheut.

Luftëtar e mendjeartë,
Nder e besë e mirësi
As përgjunjur, as firosur
Veshur, ngjeshur Kuq e Zi.

*

Tel sharkie Drini i Zi
Temperohet buzë Strugës
Mbi nëntë male me nëntë krushq
Si një zanë zbret në Kukës.

Hedh një varkë bërë prej letre
Si rrëfenjë a poezi,
Si përrallë a gjëegjëzë
Si një mal me dashuri.

GURI I SHQIPES

Ndanë fshatit qëndron një gur i madh
“Guri i Shqipes” i thonë,
Aty një trim mbështeti kryet,
Dhe hapi krahët të fluturojë, thonë!...

Rrodhi aq shumë gjak
Nga krahët, nga plagët,
Sa guri u njom dhe zuri rrënjë.
Thonë se aty në gurë kanë mbetur
Ca pendë shqiponje, thonë...

1988

REFREN KUJTESE

-Kushtuar Gj.Doçit-

Në çeljen e pranverës të shoh gjithmonë,
Mes pishash harlisur me krrelat në ballë,
Buzë Liqenit të Luleve ushton si jehonë,
I qeshur me shokë e bashkëfshatarë.

Sa herë del dielli, mbi supe të ndalet,
Sa herë del hëna, mbi vetulla të shfaqet,
Sa herë del ylberi, në ballë i lidh harqet,
Sa herë nis kënga, në buzë të kallet.

Ti je fillim i çdo vargu, çdo udhe.
Je nisja e dasmorëve, refreni në këngë
Orteku i dëborës në Kurorë të Lurës
Gjelbërimi i tërfilit e malli si brengë.

1985

PËRROI I VENDLINDJES

Si një ninullë për kullën time
Një grusht uji je në verë,
Kur në vjeshtë mblidhen prodhimet,
Rritesh ti me shi dhe erë.

Ti që sjell motive malli
Kryet vë në gjoksin tim
Dhe dëgjoj tik-takun tënd,
Si një mall e mërmërimë.

E sa herë që bie mbrëmja
Si mëndafshi ndër lajthi,
Pranë dritares luan syrin
Si kodoshi, sevdalli.

Ç'ka se vend nuk bën në hartë
Dhe në Drin derdhesh modest,
Rrjedh në "hartën" e syve t'mi
Jetë e dritë bëhesh në Fierzë.

1988

QËNDISMAT E VAJZAVE

Të gjitha lulet çelin vajzat në qëndisma,
Gjithë burimet mbledhin në shamia,
Buzët, qeshjen, zërin, betejat me krisma,
E mendsh luaj nga zilia!

Dhe çmendet ftoi nga e verdha
Dhe këputen mollët nga merak, u,
Zambaku digjet nga zilia
Dhe shqipja ngrihet nga bajraku!

1985

KËNGA E DRINIT

Kënga e Drinit pranë kullës time
Tund perdet prej basme,
Gu-gu-të e guguçeve,
Thurin ojna dasme.

Kënga e Drinit,
Në krahë dallëndyshesh
Si ninulla në djep,
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet...

Kënga e Drinit
Çel lulet e mollës
Në trung e në degë,
Shkrin akullin e borës
Në pllajë e në shkrep,
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet!

Kënga e Drinit piskamë e dhimbje
Në Dardh e në Reç!
E,
Kushedi sa kohë,
E,
Kushedi sa vjet...

1992

MALET E VENDLINDJES

Vështrimin e hedh tutje në luginë
Ku si krisma pushke shtrihen dy vargmale,
Si plak i urtë kotet Maja e Madhe,
Tutje Guri i Shqipes si shami në valle.

Me maja që puthen e nduken me retë,
Skifterët e shqiponjat aty ngrenë foletë,
Dëbora ia beh pa ardh' vjesht' e tretë,
Dielli dhe hëna mprehin sytë në kreshtë.

Male, male, në varg lidhen malet
Në shekuj qëndresë, në mote me hallet
Zgjatur, temperuar si tela sharkie,
Lindur Promete flak' e zjarr lirie.

Shikimin e tres lart nëpër maja,
Në burimet e borës, në pyje, në pllaja
Rinohem, burrërohem, plakem, urtohem
E si njëqind diej ndriçoj e shumohem.

1985

E QESHURA JONË

Rrjedh si burim i bjeshkëve
E pastër, e çiltër, e kristaltë;
Çdo ditë e jona pikë djerse,
Çdo fjalë e jona ujëvarë e bardhë!

E qeshura jonë këngë dhe dritë,
E qeshura jonë motiv poezishë,
Shkrin si kristali i dëborës,
Në shpate e flatra dashurishë.

E qeshura jonë, e bukura
Krahëshkruar si flutura!

*

Ne qeshim se duhet të qeshim
Si tufë dhishë udhë e pa udhë,
Kur stinët harrohen në kryqëzime
Me qeshjen e shtirur në buzë.

1994

PI CIGARE BESNIKU

Pi cigare Besniku
Që në vogëli,
Thithe një herë më lutet.
E thith me shpirt
E kolla Bardhaj-Reçin
Për mjekre e trondit.

Në kraharorin tim
Kockat shkanë,
Mishi tronditet,
Mendja dorovitet
Rrugë e pa rrugë,
Anë e pa anë.

Thithe një herë,
Më lutet Besniku.
Shpirti më hepohet
Dridhet, temperohet,
Si varka mbi valë.

PRANË

Hera herës më shfaqesh në faqe libri
Buzëqeshja jote në vargje në shkronja,
Dhe s'mundem të kthehem në një rimë,
Kur vjen më përkëdhel me duart e njoma.

Në udhë kur jam i vetëm nëpër natë
Më duket se pranë të kam dhe ty,
Lodhjen e hedh pas krahëve, e dashur,
Të ndjej e të shoh në shpirt e në sy.

Kur bien yjet, rëndohen qepallat,
Gjumin ma trazon lehtë si shtojzovalle
Në reflekse yjesh si në rubaire,
Si gonxhe zambaku fshehur në petale.

Vargje hedh pafund në fletë
Dielli të çelë as e ka ndërmend.

19 maj 1988

HESHTJA

Flas me heshtjen,
Mërmëris nga halli,
Kyçi sytë nga malli,
Me nofulla si kali,
I djegur si zjarri,
Kërrusur si hamalli,
I paudhë si djalli...

Ti si asht i mushtit
Ndrin si Udhë e Qumështit!

GJERSA TË VISH

Në muzgje të purpurta, të përpjeta
Me motive sythe poezish,
Me vargjet po thur gërsheta
Si kalë i pagjumë, gjersa ti të vish.

Ti erdhe me kallëza gruri në flokë,
Me të kuqtë e paktë në faqe,
Fjalët e rimat mblidhen, bëhen tok
Dhe çelin në mollëza manushaqe!

Maj 1988

NË QYTETIN E RI TË BULQIZËS

Një buzëqeshje fëmije
Mbi buzët hollë shtrënguar,
Mëngjesin çkyç në duar;
Me shpirt të përmalluar,

Qyteti i vjetër në anë,
Pallatet e rinj përballë
Gjithë diellin zbritur kanë,
Sikur po djegin dynjanë!

Ecën muratori plak
Në këtë qytet të ri
Me ylberin e kohës harkuar në sy,
Me plumbçe, nivel e mistri!

Me shpirt të përmalluar
I vetëm, i tretur, i harruar!

Maj 1988

VAJZA NGA FSHATI

Ulur në shkallë të gurta
Mbledh zogjtë në qëndisma,
Krahë fluturash e burbuqe
Erë lulesh dhe lisna.

Mbledh valët nga lumi
E trembet si një bukëls,
Ca rrokje në fletore
Si gjurmë në mes të udhës.

Ndarë në mes të udhës
Çuditërisht: fe-j-es-a,
Shtanget në fletore
Dhe pika...dhe presja.

Në shkallët e gurta
Si nyje në një ëndërr,
Mjegulla është përpara
Lak, acar në zhgjëndërr.

Ca rrokje në fletore
Gjurmë në mes të rrugës...

RRJESHTI

-Motiv nga Fusha e Bujarit-

Ne, nxënësit, në njëshkolonë
Shkelim gjurmët e mushkave,
Mos e prishni rreshtin!
Hakërrehen mësuesit.

Udha e përpjetë,
E ngushtë për ëndrrat tona,
Një murriz i plakur,
Një grusht me xixëllonja!

1996

NDARJA

Jam i mpirë e i dërrmuar
Bosh i mbetur, i harruar,
Ike më le pa udhë në natë
Pa zjarr në sy e gjurmë në prag.

E thellë kjo dhimbje, e thellë;
E trishtë kjo hënë, e mjerë,
Si ndodhi, as vetë nuk e di,
Gishtat e natës kërcas në vetmi.

Ike si dielli në perëndim
Pa gjasma rilindje në agim,
Re, shkrepitima nëpër sy,
Shpresa pa shpresë, e akullt pa ty!

Udha, si udha mbeti e shkretë,
Ankthi si ankth, as moti s'e tret,
Zemra si zemër mbledhur në grusht
Sytë si sy, si kripa në prush!

1988

PËRSËRI PËR TY

Sot kam pirë pafund verë
Si gjak Krishti gjer në të gdhirë,
I bërë tapë i gjithi vrerë,
E krejt i dëlirë, e krejt i mpirë...

Ti ike, u zhduke si kometë,
Krahët m'i ktheve përgjithmonë;
Dhe flisja me qiellin, me yjet, retë
I vetëm, i dehur gjer natën vonë.

Pastaj të vijnë Zanat e malit,
Pafund të derdhin lot e mëshirë,
Unë prapë me ty do të mbyll qepallin
E prapë me ty si pëllumb i lirë.

Në sy dhimbje, brymë dhe lot,
Heshtja si qiri fikej përtej,
Me hënën do të pi në një gotë të thyer,
Një gotë të thyer si ty do ta gjej.

1991

BIOGRAFI

- Mikut tim, poetit Islam Çenga-

Dalje-Hyrje. Plus. Minus.

Hyrja-Dalja.

Libër magazine. Sinus. Kosinus.

Rakordim amebash qepur me penjë algash...

Molusqe pa formë, pa trajtë, si akrepa,

Më tutje shumëkëmbështa pa këmbë...

Gjithnjë më tutje, kërminj pa sens, gjithë jargë

Mbetur si qyrre të fshira me mëngë...

A ka inventar deti?

Magazinier nuk bëhet poeti!

Qershor 2016

PRANË E LARG

-Mikut tim, Shkëlzen Aliaj-

Jemi larg,
Jemi ku e ku larg!
Ditën,
Nga lindja deri në perëndim të diellit;
Natën,
Dashurojmë forma të ndryshme hëne...

Jemi larg.
Në udhë ta ndjej hapin,
Në shpirt,
Valën e Valbonës
Në krenari,
Malin e Shkëlzenit,
Në sy,
Pyjet e gështenjës!

Më ndje, shok i shtrenjtë,
Në terrin e natës
Udha e pabesë!
Në palcën e dimrit
Acarri të pret!
Por...
Në rrëpirat e djegura
Si lisi pret Diellin,
Në Bjeshkët e Namuna
Merr në krah tan' Qiellin!

...

Xixëllonja-yje po mbledh në grusht
Në Bietigheim po i nis,
Si një mall për ty,
Si rudinë Kërnaje,
Si fole me prush!

DRITËRO AGOLLIT

Dritëroi ndezi qiririn nga të dyja anët
Pamje e mrekullueshme gjenu!

Në të dyja anët i ndezur qiriu
As e ftoh, as e shuan veriu...!

ARBËRESHËVE

Ju ikët nga Arbëria e dashur
Dhe përballë saj qëndruat,
S'ju trembi lufta e përhershme
Se ju në luftë u pagëzuat.

Ja, përtej Adriatikut
Përcillni ju valët e mallit,
Me mollzat e erës shpërdani
Lulet në tokën e Arbërit.

Ju shoh si lidhni ylberët,
Ylberët e syve të bukur,
E skip e shqip flasim shtruar,
E bëhem shumë herë i lumtur.

Na ndrisin sytë dhe balli,
Kur qeshim dhe flasim njësoj,
Them se nuk shprishet gjaku,
Largësinë e stinët harroj.

Gusht 1983

* * *

Buzët plasariten e shkrumb nga etja
Në lukth si kërcelli ngec fjala,
Jam i lodhur nga cinikët, paranojakët
Nga liliputët, servilët, lajkatarët.

* * *

Kam shkallë për t'u ngjitur në qiell,
Kam fjalë dashurie për mimosat,
Kam zemër që dridhet nga dhimbja,
Kam lotët që ndrisin në mollëzat.

Kam emrin e gjyshit, të stërgjyshit,
Kam eshtra që ngrihen mbi bedena,
Kam gjakun të pa mpiksur ende
Dhe shpirtin si magmë nga brenda...

XHEVDETI

Xhevdeti e ka babain shef kuadri
Vesh këpucë në vjeshtë,
Çizme në dimër,
Sandale në verë;
Nuk e kam zili për këto e të tjera,
Por për çantën prej meshini,
E unë me beze të zezë.

Xhevdeti e ka nënën shitëse në fshat,
Ha bukë gruri e gurabie merr në shkollë,
Nuk e kam zili për këto e të tjera,
Por për dhjetat që i merr
Pa mund e pa zor.

Xhevdeti ka një shtëpi dykatëshe
Perde tyli,
Televizor,
Frigorifer për të ngrirë,
Nuk e kam zili për këto e të tjera,
Por kur krekoset
Si miush i lëpirë.

Xhevdeti e ka babain shef kuadri
E të tjera,
E të tjera,
E të tjera ...

TREGUESI I LËNDËS

1 - Varg lidhur malet

Atdheu.....	9
Në vend të baladës.....	10
E treguar për kalin.....	11
Gjirokastër, prill, 2003.....	12
Rekuiem - Sokol Olldashit.....	15
C.V. Në kohën e diktaturës.....	18
“Shkencë”.....	20
Sekretari i partisë.....	21
Llamba e vajurit.....	22
Përjetim.....	23
Pylli me pisha.....	24
Kulla.....	25
Qasje.....	26
Epitaf në akull.....	27
Në Sharr.....	28
Shtator, 1986.....	29
“Rrënjë katrore”.....	30
Faraonë e skllevër.....	32
Rima prej bore.....	33
Ngricë.....	34

Po vjen dimri.....	35
Lule lisne.....	36
Përsëri për vete.....	37
Ku bashkohet Drini me Bunën.....	38
Mbrëmja në fshat.....	39
Për vete.....	40
Era është zëri im.....	41
Rrokjet.....	42
Gjurmë.....	44
Galaktikë.....	45
Korabi.....	46
Harku i ylberit.....	47
Nëna.....	48
Era.....	49
Prush lisi.....	51
Shkodër, tetor, 2006.....	52
Bashkimi.....	53
Mahmut Dac' Kalisi.....	54
Vargje majëkrahë.....	55
Deti Jon.....	56
Fletore detyrash.....	57
Pejë, pranverë 2016.....	58
Pjergulla.....	59
Gjithçka jam	60
Prekaz, qershor 2016.....	62
Kam ëndërruar.....	63

11 - Zemra ime që kurrë s'e kam parë

Përsëri për shiun.....	67
Stresi.....	68
Dëshirë fikse.....	69
Ndjenjë e turbullt.....	70
Kënga.....	71
Ndarë.....	72
Pa titull.....	73
Njerëzit kërmij.....	74
Pak vargje për delet.....	75
E shkruar për vdekjen.....	76
Migjeni më sfidoi mbrëmë.....	78
E moçme.....	80
Dhe gjumi ikën.....	81
Çast.....	82
Etyd.....	83
Pritja.....	84
Trill i hershëm.....	85
Celulari.....	86
I malluar, i djegur.....	87
Për tek ti.....	88
Fëmijëri.....	89
Abstraksion.....	90
Adoleshencë.....	91

Për ty.....	92
Ëndërr.....	93
Fjala.....	94
Motive në shi.....	95
Dhe vitet ikin.....	96
Karshi për karshi.....	97
Deti i moshës.....	98
Vjeshta.....	101
Mall.....	102
Baladë.....	103
Rima në dimër.....	105
Përsëri në ëndërr.....	106
Kulumbritë.....	107
Zjarrmia.....	108
Kur jam vetëm.....	109
Ikja.....	110
Pranvera erdhi.....	111

III - Çmendet ftoi nga e verdha

Atëherë.....	115
Bisedë e vonë me ty.....	116
Kthim në fëmijëri.....	117
Vargje në udhë.....	118
Kalëron Drini i Zi.....	123

Guri i shqipes.....	129
Refren kujtese.....	130
Përroi i vendlindjes.....	131
Qëndismat e vajzave.....	132
Kënga e Drinit.....	133
Malet e vendlindjes.....	135
E qeshura jonë.....	136
Pi cigare Besniku.....	137
Pranë.....	138
Heshtja.....	139
Gjersa të vish.....	140
Në qytetin e ri të Bulqizës.....	141
Vajza nga fshati.....	142
Rrjeshti.....	143
Ndarja.....	144
Përsëri për ty.....	145
Biografi.....	146
Pranë e larg	147
Dritëro Agollit.....	149
Arbëreshëve	150
* * *	151
* * *	152
Xhevdeti.....	153

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Udhë në pasqyrë: poezi / Ahmet Prençi.
red. Besnik Mustafaj.- Tiranë: M & B, 2016.
160 f. ; 14 x 20.5 cm.

Bibliogr.

ISBN: 978-9928-172-85-3

1.Letërsia shqipe 2.Poezia

821.18 -1
